



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 3, Datë 20.02.2017

PËR EMËRTIMIN E NJË BIBLOTEKE BASHKIAKE ME EMRIN “MUSINE KOKALARI”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.7 shkronja “b”, nenit 25 pika 3, nenit 54 shkronja “ll” dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” pasi mori në shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin për emërtimin e një biblioteke bashkiake me emrin “Musine Kokalari” Këshilli Bashkiak i Tiranës,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për emërtimin e bibliotekës bashkiake me emrin “Musine Kokalari”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI